

Мишљене Доре Бакојани, којим се препоручује чланство Приштине у Савету Европе, усвојено је у политичком комитету Парламентарне скупштине СЕ са 31 гласом за. Против је гласало четворо, а један је био уздржан.



Политички комитет ПССЕ дао зелено светло за пријем Косова у Савет Европе

Политички комитет Парламентарне скупштине Савета Европе (ПССЕ) донео је на данашњем састанку у Паризу одлуку да препоручи позивање Косова у чланство Савета Европе.

Ова одлука објављена је на налогу тог комитета ПССЕ на друштвеној мрежи Икс.



Kreshnik Ahmeti

38 мин. · 🌐

Kosova kalon suksesshëm votimin në Komitetin e Asamblesë Parlamentare të KiE

Sapo është miratuar opinionioni i raportueses Bakoyannis në Komitetin për Çështje Politike dhe Demokraci të Këshillit të Evropës.

Ky opinion rekomandon anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës pa asnjë parakusht shtesë. Asnjë nga zotimet që duhet t'i marrë përsipër Kosova nuk kërkohet të realizohen para anëtarësimit. Madje në pikën 11 thuhet qartë se zotimi duhet të adresohet pas anëtarësimit.

Të gjitha propozimet që të vendosen parakushte të reja janë refuzuar nga shumica e anëtarëve të Komitetit, gjë që tregon se Kosova duhet të bëhet anëtare në maj të këtij viti dhe parakushtet e reja do të ishin të padrejta.

Për më tepër, opinionioni kërkon largimin e fusnotës nga denominimi i Kosovës, fusnotë e cila është përdorur që nga viti 2008 në çdo raport dhe komunikim mbi dhe me Kosovën. Gjithashtu, rekomandohet që Kosova të ftohet si shtet (state), sipas nenit 4 të Statutit të KiE, dhe jo si vend (country), sipas nenit 5.

Suksesi i sotëm hapë rrugën për votimin e opinionit në sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i cili do të mbahet në Strasburg në javën e 15 prillit. Pas votimit të suksesshëm aty, opinionioni do t'i dërgohet Komitetit të Ministrave të cilët duhet të votojnë për anëtarësimin e Kosovës në ministerialin e radhës që do të mbahet në maj të këtij viti.

Teksti i opinionit dhe suksesi i sotëm janë rezultate të një pune të pandalshme të të gjitha institucioneve të Kosovës dhe koordinimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtar.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve të vendit.

© 2024 Keshnik Ahmeti. Të gjitha të drejtat rezervuara. Kështu që, nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni Keshnik Ahmeti në Twitter ose Facebook.